



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQSOR VLORE

NR.462 I REGJ

NR.30 I VENDIMIT
DATE 01.07.2014

VENDIM

"NE EMER TE REPUBLIKES"

Gjykata e Shtkalles se Pare Vlore, e perbere prej:
Hektor Sinanaj-Gjyqtar

Asistuar prej sekretares gjyqsore Lelteri Spaho, ne seance gjyqsore publike, mori ne shqyrtim ceshtjen penale e vecante,qe i perket :

KERKUES [redacted] i biri [redacted] dhe [redacted] dtl.21.11.1976,lindur [redacted] dhe banues ne adresen [redacted] perfaqsuar me prokure nga avokati [redacted]

[redacted] i biri [redacted] dhe [redacted] dtl.27.04.1989,lindur ne [redacted] dhe banues ne [redacted] perfaqsuar me prokure nga avokat [redacted]

OBJEKTI : Kerkohet kthimi i sendeve personale te sekuestruara(Dodge Shelby Dakota.5900 cm3.210 kw me ngjyre blu te erret me karoceri,me targa [redacted] dhe mjete tjeter te tipit TRIUMPH Rocket III.2300 cm3 me ngjyre i zi,me targa [redacted] pronar i te cilave eshte djali i te arrestuarit ne shtetin shqiptar [redacted],emri i te cilit eshte si emri babait te tij [redacted] i dt. 21.11.1976,i biri i [redacted] i dtl.178.10.1956,gjithashtu te kthehet mjete tjeter i tipit Suzuki Swift.1300 cm3 ,me ngjyre te bardhe me targa [redacted] pronar i te cilit eshte [redacted] dtl.27.04.1989,i biri i [redacted]

Me Pjesmarrjen e Prokurorise se Rrethit Gjyqsor Vlore,perfaqsuar nga prokurori [redacted]

BAZA LIGJORE : Neni 480,190/I,germa e dhe pika 2 ,si dhe neni 217/I i K.Pr.P.

Gjykata ne perfundim te gjykimit,pasi shqyrtoi e administroi aktet e provat shkresore,degjoi palet ne konkluzionet perfundimtare qe kerkuan :

Kerkuesi nepermjet perfaqsesit , sipas objektit te kerkeses.

Prokuroria mospranimin e kerkeses.

VEREN :

Ne kerkesen e paraqitur nga pala kerkuese nepermjet avokatit te tyre me prokure ,pretendohet si me poshte :

* Gjykata e Rrethit Gjyqsor Vlore,me Vendimin dt.26.12.2011 ka vendosur te miratoje kerkesen e prokurorise per ekstradimin e te pandehurit [redacted] per kryerjen e vepres penale te Mashtrimit,bazuar ne nenin 488 e vijues te K.Pr.P.

Organi proçedues gjate zhvillimit te hetimeve paraprake,nepermjet oficerit te policise gjyqsore me proçesverbalin per sekuestrimin e sendeve ka sekuestruar si

prova materiale perveç dokumentave qe i perkesin te pandehurit ne gjykim kane sekuestruar gjithashtu edhe mjete e neposhtme :

Dodge Shelby Dakota.5900 cm³.210 kw me ngjyre blu te erret me karoceri,me targa [redacted] dhe njetin tjeter te tipit TRIUMPH Rocket III,2300 cm³ me ngjyre i zi,me targa [redacted] pronar i te cilave eshte djali i te arrestuarit ne shtetin shqiptar [redacted] emri i te cilit eshte si emri babait te tij [redacted] dt. 21.11.1976,i biri i [redacted] dtl.178.10.1956,gjithashtu te kthehet njeti tjeter i tipit Suzuki Swift,1300 cm³ me ngjyre te bardhe me targa [redacted] pronar i te cilit eshte [redacted] i dtl.27.04.1989,i biri i [redacted]

Bazuar ne nenin 190 pika 2 citohet se :Provat materiale mund tu kthehen personave qe u takojne edhe para mbarimit te procedimit kur nuk demtohet zgjidhja e ceshtjes. Bazuar ne kete pike automjetet e sekuestruara nuk jane pronesi e te pandehurit dhe per kete arsye nuk mund te demtohet zgjidhja e ceshtjes pas kthimit te sendeve.

Ndaj te pandehurit [redacted] ka nisur procedimi penal per vepren penale te "Pastrimit te produkteve te vepres penale" dhe sipas prokurorise automjetet qe jane sekuestruar ketij shtetasi jane produkt i vepres penale,por qe ne fakt keto automjete siq permendem me siper nuk kane lidhje me te arrestuarin pasi jane ne pronesi te djemve te tij dhe si te tilla duhet tu kthehen personave qe u takojne.

Gjithashtu bazuar ne nenin 217/1 te K.Pr.P. Ne te cilen citohet se " Kur eshte e nevojshme mbajtja e sekuestros per qellime prove sendet e sekuestruara i kthehen atij qe i takojne edhe para se te merret vendimi perfundimtar ".pra dhe ne rastin konkret mund te themi se sendet e sekuestruara jane sende private te djemve te arrestuarit dhe si te tilla nuk kane lidhje me procedimin penal. Ne fjale,pra nuk perbene objekt prove materiale dhe si te tilla kthimi i sendeve personale nuk demton zgjidhjen e ceshtjes".

Nga ana e mbrojtje i eshte bere kerkese organit te procedures per kthimin e automjeteve te sekuestruara si me siper me aresyctimin se keto automjete nuk jane ne pronesi te pandehurit por te djemve te tij. Nga na e prokurorise nuk eshte kthyer pergjigje ne lidhje me kerkesen,prandaj kerkuesit i jane drejtuar Gjykates.

Per te vertetuar pretendimet e saj pala kerkuese paraqiti si prova :

Vendimin e Gjykates Apelit Vlore Nr.207 dt.07.06.2013,i cili ka ndryshuar Vendimin Nr.447 dt.09.10.2012 te Gjykates Rrethit Gjyqsor Vlore,duke i deklaruar fajtor te pandehurit [redacted] dhe [redacted] per kryerjen e vepres penale te "Pastrimit te produkteve te vepres penale".

Leje qarkullimi,regjistrim i automjeteve perkthyer nga [redacted] ne merit [redacted] per nje motorr TRIUMPH dhe per nje motorr DODGE SHELBY.

Gjykata e'mon ndryshe nga sa pretendon pala kerkuese,se sipas Vendimit te Gjykates se Apelit Nr.207 dt.07.06.2013,nder te tjera ne faqen 12.theksohet :'' Ne baze te nenit 275/2 te K.Pr.Penale,ne kushtet e nje vendimi denimi,efektet e sekuestros se vendosur mbi pasurine e te pandehurve,sipas procesverbalit te dates 01.03.2012 vazhdojne''

Pra nuk kemi shfuqizim te vendimit te sekuestros me vendim penal. Sendet e sekuestruara jane percaktuar e sekuestruar se sende qe rrjedhin nga vepra penale e "Pastrimit te produkteve te vepres penale".

Provat e paraqitura si me larte te lejes qarkullimit dhe regjistrimit te mjeteve motorrik,nuk gjenden prova autentike. Vertet ato jane perkthyer e legalizuar para nje

noteri, por nuk jane legalizuar si prova shkruesore te ardhura nga jashte shtetit, nepenjet Ministrise se Jashme.

Aktualisht ceshtja eshte ne gjykim ne Gjykatën e Larte mbi ankimin e te pandehurve.

PER KETO ARESYE :

Gjykata pasi pa dhe nenet 190 e 275 te K.Pr.P.

VENDOSI :

Rezimin e kerkeses se kerkuesve [redacted] dhe [redacted] me objekt Kthimin e sendeve te sekuestruara si kerkese e pabazuar ne ligj dhe ne prova.

Shpenzimet gjyqsore kerkuesve.

Kunder vendimit lejohet ankimi ne Gjykatën e Apelit Vlore, brenda 10 diteve. Per palen ne mungese afati i ankimit fillon nga dita e komunikimit te vendimit.

DI.02.07.2014

**SEKRETARE
LEFTERI SPAHO**



**GJYQTARI
HEKTOR SINANAJ**



Vendimi mori forme te prere me vendimin nr. 132 date 02.10.2014 te Gjykates se Apelit Vlore e cila ka vendosur :

- Lenien ne fuqi te vendimit me Nr. 30 date 01.07.2014 te Gjykates se Shkalles se Pare Vlore.

**KANCELARE
REZARTA TAUSHANI**

